

VENDIM
Nr.489, datë 23.6.2010

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE
TË KURIMIT TË SHTETASES LILIANA MLLOJA, NË ITALI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 13 të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2010, në artikullin “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 2 000 000 (dy milionë) lekësh, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të shtetases Liliana Mlloja, në Itali.

2. Efektet financiare për mbulimin e këtyre shpenzimeve përballohen nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Pagesat të bëhen kundrejt paraqitjes së faturave origjinale të institucionit shëndetësor të kurimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha